

URDHËR
Nr. 163, datë 26.7.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E DREJTORISË QË DUHET TË PËRMBUSHË ROLIN E
AUTORITETIT MENAXHUES E TË DREJTUESIT TË AUTORITETIT
MENAXHUES, SI DHE DELEGIMI I TË DREJTAVE TË NËNSHKRIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të aneksit B, nënseksioni 3, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022; të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe në përputhje me nenin 8, pika 8, dhe nenin 12, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e autoritetit menaxhues të Programit Operativ Shumëvjeçar për energjinë (2024–2027), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Znj. Edesa Metaj, si drejtues i Drejtorisë së Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë është drejtuesi i autoritetit menaxhues, në përputhje me nenin 8, pika 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III).

3. Znj. Edesa Metaj, si drejtues i autoritetit menaxhues, është e autorizuar të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

a) Marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin nën menaxhimin indirekt të programit operativ shumëvjeçar për energjinë (2024–2027) në Republikën e Shqipërisë;

b) Marrëveshjet me marrësit fundorë të ndihmës IPA III;

c) Manualet e procedurave IPA III të zbatueshme për autoritetin menaxhues;

ç) Çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me IPA III drejtuar koordinatorit kombëtar të ISPA-s, zyrtarit kombëtar autorizues, autoritetit auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organeve të ndërmjetme për menaxhimin e politikave, Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, AFCOS, Delegacionit Evropian, Shërbimeve të Komisionit Evropian, programeve të tjera që menaxhojnë autoritetet ose organet e ndërmjetme.

4. Urdhri nr. 42, datë 22.2.2024, “Për përcaktimin e drejtorisë që duhet të përmbushë rolin e autoritetit menaxhues e të drejtuesit të autoritetit menaxhues, si dhe delegimi i të drejtave të nënshkrimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet znj. Edesa Metaj dhe Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku